



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 160

Tiranë – E mërkurë, 13 tetor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 102/2021, datë 7.10.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 29, datë 13.9.2021, “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export B.V.</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021”.....	14833
Dekret i Presidentit nr. 13266, datë 12.10.2021	Për shpallje ligji.....	14833
Dekret i Presidentit nr. 13264, datë 7.10.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	14833
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 194, datë 22.9.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.....	14834
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 195, datë 22.9.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.....	14836
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 196, datë 22.9.2021	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj.....	14837
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 15, datë 7.10.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	14838

Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 544, datë 29.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit’”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 151, datë 30.9.2021.....

14845

**LIGJ**
Nr. 102/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 29, DATË
13.9.2021, “PËR MIRATIMIN E TEKSTIT
TË DISA NDRYSHIMEVE NË
MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN
DHE FURNIZIMIN NGA DHE
NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME
AKTIN NORMATIV NR. 3,
DATË 18.1.2021”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
29, datë 13.9.2021 “Për miratimin e tekstit të disa
ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe
furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*
dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për
Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik,
miratuar me aktin normativ nr. 3, datë
18.1.2021”.

Miratuar më datë 7.10.2021.

**Shpallur me dekretin nr.13266, datë 12.10.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 13266, datë 12.10.2021**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93
të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 102/2021, “Për miratimin
e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 29, datë
13.9.2021, Për miratimin e tekstit të disa
ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe
furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*
dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për
Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik,
miratuar me aktin normativ nr. 3, datë
18.1.2021”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 13264, datë 7.10.2021**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit
93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13 e 20, të
ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me
propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me
kërkesën e saj, personit të mëposhtëm:
Anila Stavri Spirollari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet
në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta
Faqe | 14833



VENDIM
Nr. 194, datë 22.9.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË FTL
SHA, PËR SHTYRJEN E HYRJES NË
FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË
ERE-s NR. 202, DATË 2.12.2020, PËR
MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E SHITJES SË
TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NË TREGUN E PARREGULLUAR PËR
SHOQËRINË PUBLIKE TË
FURNIZIMIT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 11, pikat 2 dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/4 prot., datë 20.9.2021, të Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 2.12.2020, vendosi miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.

- Me vendimin nr. 156, datë 30.6.2021, Bordi i ERE-s vendosi:

- Pranimin e kërkesës për shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020.

- Afati i hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë

publike të furnizimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, shtyhet deri më 15 shtator 2021.

- Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a.”, të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

- FTL sh.a. të raportojë në ERE çdo 30 ditë për ecurinë e implementimit dhe përshtatjen e platformës IT.

- FTL sh.a. të përgatisë strategjinë/metodologjinë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, siç përcaktuar në nenin 13, pika 1, të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, deri më 15 shtator 2021.

- Shoqëria (FTL sh.a.) nëpërmjet shkresës nr. 1829/2 prot., datë 31.8.2021, me lëndë: “Vijim komunikimi mbi platformën IT *online* të shitjes së energjisë elektrike” dhe shkresës nr. 2593/1 prot., datë 9.9.2021, protokolluar në ERE me nr. 941 prot., datë 13.9.2021, ka bërë me dije se: “... se procedura e prokurimit me objekt: ‘Mbi ndryshimet/zhvillimet në platformën IT *online* të blerjes së energjisë elektrike’, nga data 29.6.2021, është në proces ankimimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.

- Së fundmi FTL sh.a., përmes shkresës nr. 1829/3 prot., datë 14.9.2021, protokolluar në ERE me nr. 945 prot., datë 14.9.2021, me lëndë: “Mbi zbatimin e vendimit të ERE-s nr. 156, datë 30.6.2021”, ka bërë me dije, se: “Për procedurën e prokurimit, me objekt ‘Mbi ndryshimet/zhvillimet në platformën IT *online* të blerjes së energjisë elektrike’, Komisioni i Prokurimit Publik, me vendimin nr. 579, datë 8.9.2021, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik. Në zbatim të këtij vendimi, Autoriteti Kontraktor do të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”. Shoqëria FTL sh.a. ka marrë masat për hartimin e



strategjisë/metodologjisë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, strategji e cila është në proces vlerësimi nga organet kompetente vendim-marrëse të shoqërisë”.

- Si dhe bëhet me dije përmes shkresave të përcjella edhe më herët në ERE nga ana e FTL sh.a., rezulton se shoqëria ka ndërmarrë hapa për realizimin e ndryshimit/zhvillimit të nevojshëm në platformën IT *online* të blerjes së energjisë, me qëllim përdorimin e saj edhe për procedurat e shitjes së energjisë elektrike, por këto procese po zgjasin në kohë për arsye që nuk varen vetëm nga FTL sh.a.

- ERE vlerëson se shtyrja e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, deri më 1 dhjetor 2021, do të krijonte mundësi që shoqëria FTL sh.a. të realizojë ndryshimet e nevojshme në platformën IT *online* të blerjes së energjisë elektrike, me qëllim përdorimin e kësaj platforme edhe në procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar. Afati deri më 1 dhjetor 2021 është vlerësuar i arsyeshëm nga ana e ERE-s, referuar dhe sa kërkohet në shkresën e FTL sh.a., nr. 1829/1 prot., datë 21.6.2021, protokolluar në ERE me nr. 104/10 prot., datë 22.6.2021, në të cilën shoqëria sqaron, se: “Për sa u përket ndryshimeve/zhvillimeve në platformën IT *online* të shitjes së energjisë elektrike, aktualisht procedura e prokurimit publik është në fazën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Implementimi i platformës IT *online* të shitjes së energjisë elektrike do të realizohet në një afat 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë nga data e lidhjes së kontratës së shërbimit me operatorin ekonomik fitues, të kësaj procedure prokurimi”. Nisja e llogaritjes së afatit është bërë nga data 8.09.2021, siç bërë me dije nga ana e FTL sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1829/3 prot., datë 14.9.2021, protokolluar në ERE me nr. 945 prot., datë 14.9.2021, me lëndë: “Mbi zbatimin e vendimit të ERE-s nr. 156, datë 30.06.2021”, ku ndër të tjera informohet, se: Për procedurën e prokurimit, me objekt: “Mbi ndryshimet/zhvillimet në platformën IT *online* të blerjes së energjisë elektrike”, Komisioni i Prokurimit Publik, me vendimin nr. 579, datë 8.9.2021, ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik. Në

zbatim të këtij vendimi, Autoriteti Kontraktor do të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, duke evituar edhe ndërhyrjen në procedurat e organeve të tjera.

- Tepricat e energjisë elektrike, të cilat do të tregtohen nga FTL sh.a. janë të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020.

2. Afati i hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, shtyhet deri më 1 dhjetor 2021.

3. Për periudhën tranzitore të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, FTL sh.a., për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a.”, të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

4. FTL sh.a. të marrë masa për implementimin në kohë të ndryshimeve në platformën IT, si dhe të raportojë në ERE çdo 30 ditë për ecurinë e implementimit të platformës.

5. FTL sh.a. të përcjellë në ERE një kopje të strategjisë/metodologjinë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, siç përcaktuar në nenin 13, pika 1, të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë”, FTL sh.a., miratuar me vendimin e



Bordit të ERE-s nr. 202, datë 2.12.2020, më 1 dhjetor 2021.

6. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë FTL sh.a. dhe palët e interesit të përfshira në dhënien e opinionëve për draftin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 195, datë 22.9.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ALBGAZ” SHA, PËR SHTYRJE TË
AFATIT TË VENDIMARRJES FINALE
TË BORDIT TË ERE-s, PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ”
SHA, NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË
HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 12, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/1 prot., datë 13.9.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Në vijim, ERE, me vendimet nr. 43, datë 6.3.2020, nr. 119, datë 17.7.2020, nr. 179, datë 4.11.2020, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a. për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Për shkak se subjekti parashitroi në ERE se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë COVID-19, dhe si e tillë, shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk disponon ende të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE.

- ERE është informuar se është në proces kryerja e një studimi për hapësirat e depozitimit të gazit natyror dhe përfundimi i këtij studimi do të mundësojë edhe plotësimin e dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Duke qenë se në kërkesën e shoqërisë për shtyrje të afatit nuk është dokumentuar sa dhënë argumente, në lidhje me pamundësinë e plotësimit të dokumentacionit të munguar në aplikim, vlerësohet që shoqërisë “Albgaz” sh.a. t’i lihet detyrë që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese, me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit për një periudhë më të gjatë sipas kërkesës së saj.

- Kërkesa e “Albgaz” sh.a. rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton, se:

“3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria “Albgaz” sh.a., brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese (mbi të gjithë



dokumentacionin e konstatuar si të munguar në aplikim) me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit sipas kërkesës së shoqërisë.

2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.9.2021.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 196, datë 22.9.2021

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
KRYESOR TË SHOQËRISË “ENERGY
PLUS” SHPK, NËPËRMJET SHITJES
SË 100% TË KUOTAVE TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; pikës 5.2, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 122/2 prot., datë 15.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010, i ndryshuar, si dhe licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit nr. 109, datë 22.10.2010;

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838 prot., datë 21.7.2021, shoqëria ka kërkuar nga ERE autorizimin për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 838/2 prot., datë 18.8.2021 dhe nr. 838/4 prot., datë 30.8.2021, shoqëria ka depozituar në ERE sqarime dhe dokumentacion shtesë;

- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” dhe të pikës 5.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”;

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 10.9.2021, vendosi shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave me 30 ditë, me qëllim vendosjen e komunikimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe marrjen e informacionit përkatës për fazën në të cilën ndodhet dhënia e miratimit për këtë transferim nga MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 838/5 prot., datë 10.9.2021, shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. ka depozituar një kopje të shkresës së MIE-s nr. 5792/2 prot., datë 7.9.2021, me anë të së cilës, MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka miratuar transferimin e pjesëve të kapitalit të shoqërisë koncesionare “Energy Plus” sh.p.k..

- Shoqëria ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.

- Autorizimi nga ERE jepet (duke vlerësuar edhe miratimin/qëndrimin e Autoritetit Kontraktor), me kushtin që shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., të ruajë emrin me të cilin është licencuar, si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në licencën për prodhimin e energjisë elektrike dhe licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me të cilat është pajisur.

- Në çdo rast, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërket nga këto organe.

- Në zbatim të nenit 20, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në kuadër të dhënies së informacionit nga të licencuarit, shoqëria të njoftojë ERE-n pasi



të bëhet efektiv ky transferim kuotash, sipas këtij autorizimi të dhënë nga ERE.

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1 Dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj.

2. Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/ miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 15, datë 7.10.2021

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””, Komisioni i

Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 15, datë 7.10.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtëme:

1. **Dosje nr. 119**, “Fashikull me materiale të arratisurit R. N. nga rrethi i Peshkopisë”, me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1957.

2. **Dosje nr. 103**, “Fashikull i kërkimit për bandën e kryesuar nga H. G. nga Lazarati i Gjirokastrës dhe përbërë nga diversantët B. G., A. D., B. K., A. K. nga qarku i Gjirokastrës”, me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1955.

3. **Dosje nr. 102**, “Fashikull i përgjithshëm informatash për bandën e S. P., N. B., B. Ç., B. K. dhe R. P. nga Gjirokastra”, me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1955.

4. **Dosje nr. 113**, “Udhëzim i ministrit mbi mënyrën dhe mbajtjen e evidencave dhe rregulloren në sektorin e Bandave”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1957.

5. **Dosje nr. 116**, “Dosje operative me të dhëna informative mbi qëndrën e zbulimit grek në Kostur, si dhe veprimtaria kundër vendit tonë”, me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1957.

6. **Dosje nr. 121**, “Fashikull i përgjithshëm i bandës së diversantit S. H. e V. H. nga rrethi i Sarandës”, me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1957.

7. **Dosje nr. 115**, “Detyra dhe të drejta të punëtorëve operativë të grupit të kërkimit pranë Degëve të Punëve të Brendshme”, me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1957.



8. **Dosje nr. 120**, “Fashikull i të arratisurit S. Sh. nga Dukagjini i rrethit Shkodër”, me 7(shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1957.

9. **Dosje nr. 122**, “Raport vjetor mbi veprimtarinë e bandave të armatosura dhe veprimet tona kundër tyre dhe relacion mbi asgjesimin, kapjen dhe dorëzimin e dy diversantëve”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1958.

10. **Dosje nr. 126**, “Fashikull me dokumente operative në drejtim të M. K., një nga krerët e emigracionit reaksionarë jashtë shtetit që vepron aktivisht”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1958.

11. **Dosje nr. 128**, “Relacion mbi veprimtarinë e diversantëve dërguar nga zbulimi grek kundër vendit tonë”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1958.

12. **Dosje nr. 129**, “Relacion mbi diversantin jugosllav B. H. dërguar nga zbulimi jugosllav”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1959.

13. **Dosje nr. 134**, “Lista e të arratisurve nga zbulimet e huaja kundër vendit tonë dhe statistikë e bandave, diversantëve prej vitit 1959”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1959.

14. **Dosje nr. 135**, “Fashikulli i kërkimit të bandës së A. N., dokumente të periudhës së luftës si eksponent i Ballit Kombëtar”, me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1959.

15. **Dosje nr. 63**, “Fashikull i përgjithshëm informatash i diversantit Z. K. nga Peshkopia”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1952.

16. **Dosje me** “Fashikull i përgjithshëm informatash i diversantit Z. K. nga Peshkopia”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1952.

17. **Regjistër agjiture nr. 1, model K. I.**, me

102 (njëqind e dy) fletë. Fillon me numrin rendor 1 dhe mbaron me numrin rendor 3957. Në total janë 101 (njëqind e një) fletë të plotësuara. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Propozojmë deklasifikim të plotë të regjistrit nga numri rendor 1 deri në numrin rendor 3957, që përkon me 101 (njëqind e një) fletë. Regjistri i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

18. **Dosje formulare nr. 4483**, në ngarkim të Z. F., me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

19. **Fashikull personal për të dënuar nr. 449**, në ngarkim të R. A., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtorisë e Punëve të Brendshme Tiranë.

20. **Fashikull me materiale të përpunimit të grupit klerik “Çakalli” nr. 4643**, në ngarkim të B. S., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Operativ.

21. **Dosje formulare nr. 810**, në ngarkim të D. K., me 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtorisë e Punëve të Brendshme Tiranë.

22. **Dosje fashikullore nr. 60**, në ngarkim të F. A., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Emigrantët Ekonomikë.

23. **Fashikull nr. 2365**, në ngarkim të A. B., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Fashikulli i përket Fondit ish-të Arratisur.

24. **Fashikull emigranti nr. 219**, në ngarkim të N. B., me 81 (tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtorisë e Punëve të Brendshme Tiranë.

25. **Dosje nr. 40**, në ngarkim të K. T., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

26. **Dosje formulare nr. 1753**, në ngarkim të A. T., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

27. **Dosje përpunimi nr. 3076**, në ngarkim të



K. M., me 231 (dyqind e tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.

28. **Fashikull nr. 5792**, në ngarkim të J. R., me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-të Huaj.

